

Bukuroshe ISUFAJ  
Departamenti i Gjuhëve të Huaja  
Universiteti “Ismail Qemali “  
Vlorë, SHQIPËRI  
E-mail: bukuroshe\_isufaj@yahoo.it

## SHQIPJA NË RRJEDHAT E GLOBALIZIMIT ALBANIAN LANGUAGE INTO THE GLOBAL MAINSTREAM

### Përkufizimi i termit globalizim

Termi *globalizim* përcakton një bashkësi të proceseve të integritimit në fushën socioekonomike e në komunikim që është krijuar në fund të shek. të XX. Sociologët si T. Friedman e A. Giddens shohin te globalizimi efektin e paevitueshëm të kontekstit socioekonomik botëror, që çon në tejkalimin e kulturave tradicionale e të tjera procese etnokulturore.

Dijetarët e shquar N. Chomsky, L. Gallino përcaktojnë një rol vendimtar në zgjedhjen e pushtetit ekonomik e politik ndëkombëtar të finalizuar në liberalizimin e lëvizjes së kapitaleve e të tregut të punës (Chomsky 1998). Është vështirë të kemi një përkufizim mbi këtë koncept, megjithëse studiues të ndryshëm e kanë përkufizuar në mënyra të ndryshme, si: “një proces i kapërcimit të kufijve të lindur historikisht” (Elmar Altvater); “Intensifikimi i marrëdhënieve sociale mbarëbotërore” (A. Giddens), apo siç e përkufizon Johannes Varwick “*fjalë e rëndësishme*”, duke u konsideruar nga njëra anë “kërcënim” nga tjetra “shans”.

Z. Bauman hedh dritë më tej duke e parë këtë proces si në krizën e identitetit dhe në paqartësinë e raporteve sociale që ai përcakton. Përpos përpjekjeve për përkufizime, globalizimi, sot, kuptohet në mënyra të ndryshme. Është një proces i ndërvarësisë ekonomike, kulturore, politike

e teknologjike, efektet pozitive e negative të të cilit kanë rëndësi dhe pamje planetare, si rrezik dhe perspektivë e shoqërisë planetare.

Globalizim i ideve dhe i realiteteve të botës pluraliste, shumëgjuhësore dhe shumëkulturore, si globalizim i marrëdhënieve dhe i shkëmbimit të ideve, vlerave kulturore, si integrim në tregjet financiare, në ato të mallrave e të shërbimeve, si lëvizje e njerëzve dhe kapitaleve, jo rrallëherë kuptohet edhe si zgjerim i dhunshëm i sferës së ndikimit, apo influencës së grupit të vendeve më të fuqishme .

### **Globalizimi nevojë për tjetrin**

Proceset e globalizimit shpesh herë shoqërohen edhe me frikë në popujt më pak të zhvilluar përballë atyre që për nga zhvillimi ekonomik qëndrojnë shumë më lart se ata. Popujt e Evropës edhe pse janë përfshirë në këtë proces e dinë se për arsye të shumë rrethanave të së shkuarës dhe të së tashmes, termi globalizim nuk do të thotë për ta dashuri, po nevojë për tjetrin. Parë në këtë këndvështrim, globalizimi mund të shihet me të drejtë si proces pozitiv që mund të ndihmojë edhe në vendet me zhvillim të mesëm ose të vogël ekonomik, duke i përfshirë në ekonominë, tregun dhe në informatikën globale, por edhe si rrezik për identitetin dhe ekzistencën e popujve të vegjël.

Në këto kushte, një ndër efektet e globalizimit është detyruesimi i globalizimit e për pasojë ka shkaktuar fenomenin e dekulizimit dhe çrrënjësimit e saj nën pretekstin e hegjemonisë kulturore perëndimore, përfshirë imponimin e raporteve sociale mbi mekanizmat e tregut.

Dobësimit i kulturave lokale krijon supozimet për një homogjenizim pa integrim, të karakterizuar nga diferenca të forta socioekonomike e kulturore, që sjellin migrimin e masës drejt “shtetësisë së çmuar” (Bauman 1998). Proceset e integritimit politik e ekonomik, formimi i shoqërive multikulturore e multigjuhësore dhe shfaqja e një ndërveprimi global, tregojnë ndryshime të mëdha në kulturën dhe të menduarit në një botë në të cilën distancat dhe diferencat priren të jenë gjithnjë e më pak të perceptueshme.

### **Trysnia gjuhësore**

Përsa i përket gjuhës, shumë autorë nënvizojnë procesin e zvogëlimit të numrit të gjuhëve që fliten, të homologimit të mënyrës së përdorimit të gjuhës e të rregullave të komunikimit gjuhësor: “sistemet e transmetimit perëndimor“ tentojnë imponimin e tyre tek pjesa tjetër e botës (Zolo 2004).

Procesi intensiv i globalizimit ka prekur pa diskutim edhe gjuhën, e për pasojë, ka shumë çështje për të cilat janë çelur diskutime në këtë rrafsh. Duke qenë i lidhur ngushtë me zhvillimin tekniko-teknologjik, me zhvillimin informativ-komunikues, globalizimit i referohen edhe ndryshimet që po ndodhin në hartën gjuhësore të botës, nga ku gjuha shqipe nuk bën përjashtim pasi, në një shoqëri të hapur, sic është shoqëria jonë sot, ndihet trysnia e gjuhëve të vendeve të fuqishme politikisht dhe ekonomikisht, me të cilat jemi në kontakt.

Kjo trysni është e pashmangshme në fazat e para të hapjes ndaj botës. Fjalët dhe strukturat e huaja, siç dëshmojnë edhe në këto dy dekada të ndryshimeve e zhvillimeve të vendit tonë, kanë vërshuar nga të gjitha anët, aq sa të krijohet përshtypja se po ia marrin frymën gjuhës. A kemi të drejtë të shqetësohemi, kur përditë degjojmë apo shohim përcudnime të tilla, si :” abandonoj (*braktis*), abnegacion (*vetëmohim*), abonim (*pajtim*), abort (*dështim*), abrogoj (*shfuqizoj*), absorboj (*thith*), abuzoj (*shpërdoroj*), kishin mundur të fitonin duke aplikuar me emrin e firmës (*duke përdorur emrin e ndërmarrjes*), çamët do të diskutohen në Athinë (*çështja çame do të diskutohet*), bëj avokatin, bëj mjekun (*jam mjek, avokat*), konvertoj (*këmbej*), bord (*kryesi*), integritet (*tërësi*), kredibilitet (*besim*), fazë tranzicioni (*kalimtare*), debolesë (*dobësi*), axhendë (*rend dite*), handikap (*pengesë*), demilitarizim (*çmilitarizim*), kontakti (*lidhuni*), gelateria (*akulllore*), salutoj (*përshendes*), pastiçeria (*ëmbëltore*), adaptoj (*përshtas*) adoptoj (*birësoj*), intermediar (*ndërmjetës*), premio (*çmim*), komision bipartizan (*dypartiak*), abonohem (*pajtohem*)” etj.

Pra, globalizmi është një dukuri që prek në thellësi edhe proceset gjuhësore. Por, dihet se kur diçka ndërtohet, kjo duhet të ndodhë në hapsirë të lirë, ose duhet të rrenohet diçka ekzistuese për t’i bërë vend së resë. Për këtë arsye globalizmi duhet të kuptohet dhe si proces rrënues.

Format e këtij procesi janë edhe copëzimi, lëkundja, prishja, imtësimi, çrrënjimi e rrafshimi i shteteve, i ekonomive dhe kulturave, prandaj edhe i gjuhëve. Prirje rrënuese të copëzimit vërehen edhe në hapsirën shqiptare kulturore e gjuhësore, sidomos gjuhësore. Edhe vetëçështja e identitetit kombëtar çdo ditë e më shumë paraqitet si primitivizëm për popujt e vegjël, kurse për popujt e mëdhenj e të fuqishëm si prestigj.

## **Statusi i gjuhës shqipe në proceset e globalizimit**

Fjalët dhe strukturat e huaja të përdorura me natyrë të rëndomtë në gjuhën shqipe tregojnë, se situata jonë gjuhësore flet për atë që në mjesdisin tonë globalizimi kuptohet në mënyrë të gabuar dhe në të vërtetë, por keqkuptohet dhe si pasojë e kësaj po zhvillohen një varg procesesh rrënuese për gjuhën shqipe, për kulturën shqiptare dhe, madje, për

identitetin shqiptar. Shqipja duhet të jetë gjuhë e hapur, por edhe gjuhë në ruajtje, ndaj të kërkosh mbrojtjen me ligj dhe ruajtjen e gjuhës tënde zyrtare, nuk duhet marrë aspak si shenjë ksenofobie gjuhësore. Ndër këto procese është edhe statusi i shqipes në hapësirën shqiptare dhe, sidomos jashtë kufijve, në vendet e huaja (kufitare e të largëta), ku numri i shqiptarëve me status emigrant (ekonomik apo politik) është më i madh, ndërsa shqipja si gjuhë amtare paraqitet e rrezikuar për arsyet e njohura.

Në përpjekje për copëzimin e hapësirës gjuhësore dhe përpjekjet për krijimin e gjuhëve te reja politike, shqipja përballet me dy sfida themelore:

1) Çlirimi gradual prej “gjuhës së ngurtë”, e cila shpreh perceptimin e shqiptarëve brenda kornizës së dogmës ideologjike; dhe

2) Lëvizja e lirë e njerëzve pas viteve të '90-ta ka krijuar mundësinë e qarkullimit edhe të fjalëve, të cilat dalin nga enklavat, duke kapërcyer pengesat e dikurshme, që vinin nga kufijtë politikë.

Brenda kufijve politikë lëvizja e lirë ka vënë në dyshim konceptet klasike të të folmeve dhe të dialekteve në të mirë të krijimit të sociolekteve a të një “përzierjeje të folmesh” me prurje heterogjene. Gjuha standarde ka prirje të zgjerohet dhe të marrë një fymëmarrje më të gjerë me prurje të rëndësishme dhe cilësore nga dialekti geg dhe nëndialekte të tjera.

## Degradimi i gjuhës shqipe

Ndryshimet politike e shoqërore e hapën shoqërinë shqiptare ndaj globalizimit, gjë që shoqërohet me një trysni të madhe të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe, duke e futur hera-herës në labirintet e “Kullës së Babelit”. Nga sa më sipër, dalin dy rreziqe: globalizimi dhe krahinorizimi, që të dyja të dëmshme për shqipen standarde, duke ushtruar edhe trysni ndaj saj. Kjo ka edhe disa arsye:

(a) Mungesa e ligjit për gjuhën - përpjekjet që të krijohen mekanizma të efektshëm, që do të rregullonin përdorimin publik të shqipes standarde në të gjithë hapsirën shqiptare mbetën vetëm projekt i dashamirësive të gjuhës;

(b) Zotërimi jo i plotë i normës gjuhësore sjell lëkundje të mëdha ose të vogla normative dhe, në të vërtetë vërhet çdo ditë e më shumë një inferioritet i madh i folësve të shqipes ndaj normës gjuhësore të saj. Jemi dëshmitarë se po zhvillohen procese degraduese në të gjitha rrafshet e normës gjuhësore të shqipes standarde;

(c) Rrënimi i kulturës gjuhësore, posaçërisht i kulturës së shprehjes me shkrim e me gojë;

(d) Depërtimi i shpejtë pothuajse stihik i fjalëve të huaja, sidomos i anglicizmave në gjuhën shqipe;

(e) Përdorimi i madh, përgjithësisht i fjalëve dhe elementeve të huaja, sikur po lëkund dhe dobëson strukturat gramatikore të shqipes;

(f) Problemet në rrafshin e terminologjisë, në këtë shkallë të zhvillimit të gjuhës dhe në këtë shkallë të përpjekjeve institucionale dhe individuale për ta trajtuar problemin seriozisht e me ndjeshmëri, duken të pakapërcyeshme. Mungesa e hartimit të fjalorit terminologjik, ndonëse ky problem nuk zgjidhet vetëm me hartimin e fjalorëve dhe krijimin e komisioneve. Problemet në këtë fushë i ka shtuar dhe i ka ndërlikuar interneti me “super inovazionin” e termave të tij;

(g) Varfërimi i larmisë dialektore për arsye të tërheqjes së shumë të folmeve ka bërë që shpesh të harrohet se dialektet, si bërthama themelore gjuhësore, mbeten mbështetja dhe burim i rëndësishëm për pa-surimin e shqipes standarde;

(h) Imponimi i gjuhës së mediave dhe i gjuhës bisedore si stile kryesore funksionale, ka bërë që në mediat, sidomos në ato elektronike, të bjerë ndjeshëm prestigji i shqipes standarde, si rrjedhojë jo vetëm e disiplinës së vogël gjuhësore, i padijes dhe i papërgjegjësisë së folësve, përkthyesve, redaktorëve dhe realizuesve të emisioneve, por edhe për arsye të rënies së ndjeshmërisë dhe të nderimit për kategoritë elementare të qënies së sonë kombëtare;

(i) Vulgarizimi i gjuhës së mediave, teatrove, filmit, letërsisë, si dhe i gjuhës së përditshme, çdo ditë e më shumë po krijon një lloj zhargonit që po i ngjanë gjuhës së rrugës /vërehet përpjekja që kjo gjuhë të bëhet normë e (jo) kulturës ligjërimore/;

(j) Depërtimi i drejtshkrimit të gjuhëve dhe të shkrimeve jo shqipe në sferën e përdorimit publik të gjuhës në gjithë hapsirën shqiptare – në firma, reklama, media e të tjera të ngjashme dhe shmangia ose skajimi i shqipes nga kjo sferë e përdorimit;

(k) Anglishtja (e gjuhë të tjera) ka fituar një status epërsie edhe në këtë fushë të përdorimit publik të shqipes standarde dhe nga ky aspekt mund të thuhet se, globalizimi ka bërë punën e vet – ka njëjtësuar botën më lehtë se në çdo fushë tjetër (mbishkrimet e reklamave të njëjta i gjen në krejt qytetet e botës);

(l) Ndryshimet në politikën e mësimin të gjuhevë të huaja, kanë sjellë edhe favorizimin e anglishtes në dëm të gjuhëve të tjera të huaja – frëngjishtes, gjermanishtes, italishtes e të tjera. Edhe vetë politika e mësimin të gjuhëve të huaja zhvillohet në këtë drejtim: çdo ditë e më shumë femijët tanë shkollohen në gjuhë të huaja, në radhë të parë në anglishten;

(m) Favorizimi për punësimin e atyre që njohin gjuhë të huaja, po jo dhe shqipen (shpesh në konkurset për punësim), të shfaqet si kusht kryesor që kërkohet të plotësohet nga njohja e anglishtes, ndërsa për shqipen nuk kërkohet plotësimi i asnjë lloj kushti, edhe në vendet e punës

ku “punohet”, edhe pse dihet se cila është përgatitja gjuhësore e brezit tonë të ri;

(n) Ndryshimi i statusit të gjuhësisë dhe të albanologjisë në përgjithësi; rënia e interesit për hulumtimet gjuhësore albanologjike jo vetëm në vend, por edhe jashtë, në qendrat e njohura deri vonë për studime të tilla; mungesa e mbështetjes së duhur, sidomos financiare shtetërore në të gjithë hapsirën shqiptare për hulumtime në këtë fushë, të veçantë ka edhe për pasojë sjell pakësimin e kuadrit dhe rënien e cilësisë së arsimimit. Në këtë aspekt ndalimi, trajtimi dhe mënyra e funksionimit të instituteve shkencore, zvogëlimi i kuadrit, zvogëlimi i numrit të studentëve shqiptarë dhe të huaj, pakësimi i vëllimit të botimeve albanologjike dhe rënia e madhe e cilësisë së këtyre botimeve, mungesa e ekspeditave shkencore hulumtuuese në terren, natyrisht jo me mënyrën dhe vëllimin e njëjtë në të gjithë hapësirën shqiptare etj.

### **Albanologët të marrin mësim nga të tjerët**

Institutet shkencore kanë vite që nuk përtërijnë kuadrin, ndërsa specializimet brenda e jashtë hapsirës shqiptare janë zvogëluar shumë. Në Katedrat e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe ende gjendja e kuadrove paraqitet më e rëndë se edhe në fillimet e punës së tyre, para puthuajse dyzet vjetëve. Sot një mësimdhënës ligjëron tri e katër lëndë dhe në tri e katër fakultete të ndryshme, por nuk janë të pakta edhe rastet kur mësimdhënësit nuk janë specialistë të lëndëve përkatëse dhe nuk kanë dhënë asnjë ndihmesë në fushën shkencore e profesionale. Në të vërtetë shumë nga lëndët mbulohen sa për të thënë – një gjendje kjo që do të mund të kuptohet në vitet '60 të shekullit të kaluar, po në asnjë mënyrë sot, ndonëse edhe asokohe nuk na paraqitet një gjendje e tillë, sepse në mungesë të mësimdhënësve të lëndës ftoheshin kuadrot prej universiteteve të tjera.

Del natyrshëm kërkesa që albanologjia të trajtohet si duhet në fakultete e në institute, por del natyrshëm edhe kërkesa që albanologjia të mos mbetet vetëm shkencë kabinetesh dhe akademike. Ajo duhet të marrë karakter pragmatik, sepse e kërkon koha. A kanë të gjitha këto lidhje me globalizimin? Nëse e pranojmë përgjigjen pozitive natyrshëm, shtrohet pyetja – çfarë të bëjmë?

Sigurisht që në këto kushte duhet të përpiqemi për një globalizim në kuptim të mirë të fjalës, për një integrim që nxit ndjenjat për respekt vetjak e kombëtar, për vetërespekt, për globalizimin që do të na bashkojë me të tjerët, me vlerat e ndërsjella, në të cilin edhe shqipja dhe kultura shqiptare do të zhvillohen e do të kultivohen krahas vlerave në shtrirje të gjerë planetare.

Në këtë aspekt do të duhej të shihnim edhe përtej vetes – çka bëjnë kombet e shtetet në kushtet e globalizimit? Si i pranojnë proceset pozitive e si u bëjnë ballë proceseve negative që i nxit globalizimi, si i ruajnë e si i përforcojnë vlerat e tyre, në të vërtetë si e ruajnë *identitetin* e tyre, sepse mënyra më e mirë për ta paraparë ardhmërinë tonë është ta krijojmë atë.

Me të drejtë disa albanologë, vitet e fundit, kanë vënë në dukje se si ta bëjmë shqipen mjet integrimi midis nesh dhe mjet integrimi me të tjerët, pasi një nga vlerat tona më të mëdha është gjuha, amaneti i të parëve, pjesë e vetëqenies sonë, e identitetit kombëtar, e shqiptarësisë. Ajo duhet të rrjedhë e qetë në arteriet e kombit si një vetëdije, me të cilën shqiptarët kanë lidhur jetë e mot shqiptarësinë. E thënë shkurt: të gjejmë rrugët që pajtojnë atdhetarizmin dhe globalizimin për t'u përfshirë në rrjedhat e integritit dhe qytetërimit bashkëkohor .

## Bibliografi

- CHOMSKY, N. (1998, 2004), *The common good*, Monroe (trad. it Casale Monferrato 2004).
- BAUMAN, Z. (1998), *Globalization. The human consequences*, Cambridge – Oxford (trad. it. Dentro la globalizzazione: conseguenze sulle persone, Roma-Bari);
- ZOLO, D (2004), *Globalizzazione. Una mappa dei problemi*, Roma –Bari.
- GIDENS, Entoni (Anthony Giddens, 1998)), *Posledice modernosti*, Beograd;
- GRUP autorësh (2003), *Aspekti globalizacije*, Beograd.
- HOBBSBAUM, Erik (2001), *Doba ekstrema*, Beograd.
- HUNGTINTON, P. Samuel (2004), *Përplasja e qytetërimeve dhe ribërja e rendit të ri botëror*, Logos – A, Shkup.
- KALANJ, Rade (2004), *Globalizacija i postmodernost*, Zagreb.
- RANDOVANOVIÇ, Milorad (1997), *Spisi iz kontekstualne linguistike*, Novi Sad.
- VENDRYES, Joseph (1998), *Govor*, Novi Sad.
- WWW.tirana\_observer.al

## Përmbledhje

Europa e shekullit që kemi lënë pas dhe e fillimit të këtij shekulli karakterizohet me ndryshime të mëdha, me përparim teknologjik, komunikim global dhe qarkullim të informacioneve. Në këtë kontekst bashkimi i popujve, i kulturave, i qytetërimeve dhe e traditave të tyre duket i natyrshëm. Ajo synon të bëhet pluraliste, të ruajë pasuritë e saj në njohjen e dallimeve, pra dihet për pjesët e globales. Globalizimi, kuptohet në mënyra të ndryshme dhe procesi intensiv i tij ka shtruar shumë çështje për diskutim, që mund të shtrihet në disa rrafshë si në atë kulturor, financiar, tekniko-teknologjik, inormativ-komunikues, arsimor, semiotik, etnologjik dhe në atë gjuhësor.

Fushëveprim gjuhësor i globalizimit mund të konsiderohet edhe kur një fjalë e një gjuhe botërore vendoset në leksikon e një gjuhe të vogël, duke i bërë të vdekura shumë fjalë burimore. Dukuri kjo e përhapur edhe në gjuhën shqipe. Situata jonë gjuhësore flet për një keqkuptim të termit globalizim e për pasojë po zhvillohen një varg procesesh rrënuese për gjuhën shqipe, për kulturën shqiptare, madje për identitetin shqiptar. Duke e pranuar globalizimin si një realitet me të mirat e të këqijat e veta na del detyrë ta bëjmë gjuhën e bukur shqipe mjet integrimi duke ruajtur identitetin tonë.

**Fjalët çelës:** globalizim, identitet, integrim, gjuhë, proces.

## Abstract

The Europe of the century we have left behind and the beginning of this century is characterized by major changes, with technological progress, global communication and the information flow. In this context the union of people, cultures, civilizations and their traditions seem quite common. It aims to become pluralistic, maintaining so its assets in the unification of differences, therefore to become global. The term “Globalization”, is understood in the way of diversity and its intense process has raised more issues for discussion in several areas such as in cultural, financial, technical and technological, communicative-normative, education, semiotic, ethnological, and in linguistic states.

Linguistic aspect of globalization should be considered when a question of a global language is placed in lexicon of a small language, making dead many question of mainstream. That’s a widespread phenomenon in Albanian language. Our situation is about a linguistic misunderstanding of the terms of globalization and therefore being developed for a range of devastating processes in Albanian, Albanian culture, even the Albanian identity. By accepting globalization as a reality with the best and its worst, it is our duty to make beautiful Albanian language a mean of integration while maintaining our identity.

**Key words:** globalization, identity, integrity, language, process.